



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT DHE SPORTIT

Nr. 4163/prot.
1

Tiranë, më 16 . 6 . 2022

UDHËZIM

Nr. 12 , datë 16 . 6 . 2022

PËR

**NGRITJEN DHE FUNKSIONIMIN E KOMISIONIT PËR VLERËSIMIN
PSIKO-SOCIAL TË PUNONJËSVE ARSIMORË DHE PUNONJËSVE TË
TJERË NË INSTITUCIONET ARSIMORE PARAUNIVERSITARE**

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102 të Kushtetutës dhe të shkronjës “a”, të pikës 2, të nenit 26, të ligjit nr. 69/2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar,

UDHËZOJ:

- I. NGRITJEN DHE FUNKSIONIMIN E KOMISIONIT PËR VLERËSIMIN PSIKO-SOCIAL TË PUNONJËSVE ARSIMORË DHE PUNONJËSVE TË TJERË NE INSTITUCIONET ARSIMORE PARAUNIVERSITARE
 1. Qëllimi i këtij udhëzimi është përcaktimi i rregullave mbi mënyrën e organizimit dhe funksionimit të Komisionit për vlerësimin psiko-social të punonjësve arsimorë dhe punonjësve të tjerë në institucionet arsimore parauniversitare (në vijim, “Komisioni”).
 2. Komisioni është i natyrës *ad hoc* dhe ngrihet me urdhër të titullarit të zyrës vendore të arsimit parauniversitar (ZVAP), sipas rasteve të përcaktuara në këtë udhëzim.
 3. Komisioni përbëhet nga 5 (pesë) anëtarë, të cilët janë:
 - a) Supervizori i psikologëve/punonjësve socialë, i cili është dhe kryetar i Komisionit;
 - b) punonjësi i Shërbimit Psiko-social i institucionit arsimor parauniversitar (IAP) përkatës, anëtar;
 - c) psikolog/punonjës socialë, pjesë e Njesisë së Shërbimit Psiko-social, për ZVAP-në përkatëse, anëtar;
 - d) përfaqësues nga Drejtoria Rajonale e Arsimit Parauniversitar (DRAP), anëtar;

e) përfaqësues nga ZVAP-ja përkatëse, anëtar.

4. Komisioni ka për detyrë:

- a) Vlerësimin psiko-social të punonjësve arsimorë të punësuar për herë të parë, në një institucion arsimor parauniversitar, në përfundim të periudhës kohore prej 3 (tre) muaj.
- b) Vlerësimin psiko-social të punonjësve arsimorë dhe/ose të punonjësve të tjerë të IAP, për raste të veçanta, sipas ankesave të depozituara në institucionin arsimor përkatës, në ZVAP apo në DRAP.
- c) Dërgimin e aktit të vlerësimit për punonjësin, pranë ZVAP-së përkatëse.

II. PROCEDURA PËR VLËRËSIMIN E PUNONJËSVE ARSIMORË TË PUNËSUAR PËR HERË TË PARË NË NJË POZICION PUNE PËR NJË PERIUDHË MË TË GJATË SE 3 (TRE) MUAJ.

1. Drejtori i institucionit arsimor, 15 ditë para përfundimit të periudhës 3 mujore, dërgon pranë ZVAP-së listën e punonjësve arsimorë, të punësuar për herë të parë, nëpërmjet portalit “Mësues për Shqipërinë”, për t’ju nënshtruar vlerësimit psiko-social nga Komisioni.
2. ZVAP, brenda 5 ditëve nga marrja e listës, ngre Komisionin, sipas pikës 3, të Kreut I, këtij udhëzimi.
3. Komisioni, brenda 5 ditëve nga ngritja e tij, kryen vlerësimin për punonjësin/it arsimor, sipas metodologjisë së hartuar nga Agjencia e Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar dhe përcjell këtë vlerësim në ZVAP-në përkatëse.
4. Titullari i ZVAP-së përcjell vlerësimin e Komisionit pranë drejtuesit të institucionit arsimor, i cili i bën me dije punonjësit arsimor aktin e vlerësimit.
5. Punonjësi arsimor, brenda 3 ditëve pune, ka të drejtën e ankimit mbi vlerësimin e Komisionit, pranë ZVAP-së përkatëse.
6. ZVAP, brenda 5 ditëve, shqyrton ankimin dhe njofton drejtorin e IAP-së dhe punonjësin për vlerësimin përfundimtar.
7. Në rast të vlerësimit përfundimtar pozitiv, drejtori i IAP-së lidh kontratën me punonjësin arsimor.

III. PROCEDURA PËR VLËRËSIMIN E PUNONJËSVE ARSIMORË NË DETYRË APO TË PUNONJËSVE TË TJERË TË IAP-SË

1. ZVAP, për raste të veçanta, sipas ankesave të depozituara në institucionin arsimor përkatës, në ZVAP apo në DRAP, ngre Komisionin *ad hoc*, sipas pikës 3, të Kreut I, të këtij udhëzimi, pas miratimit nga titullari i DRAP-së.

2. Komisioni, brenda 15 ditëve nga ngritja e tij, kryen vlerësimin e punonjësit dhe e dërgon atë pranë ZVAP-së.
3. Titullari i ZVAP-së, në varësi të punonjësit për të cilin është kryer vlerësimi, përcjell vlerësimin e Komisionit pranë titullarit të institucionit përkatës, i cili i bën me dije punonjësit për vlerësimin e kryer.
4. Punonjësi, brenda 3 ditëve pune, ka të drejtën e ankimit për vlerësimin e Komisionit, pranë ZVAP-së përkatëse.
5. ZVAP, brenda 5 ditëve, shqyrton ankimin dhe njofton titullarin e institucionit përgjegjës për punësimin e punonjësit, si dhe punonjësën subjekt të vlerësimit.
6. Drejtori i IAP-së për punonjësit arsimorë pas vlerësimit përfundimtar jopozitiv, merr masa për ndjekjen e procedurave administrative sipas akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi.
7. Drejtori i IAP-së, për punonjësit e tjerë, përcjell vlerësimin përfundimtar të ZVAP-së, në institucionin përgjegjës për punësimin e tyre.
8. DRAP, për drejtorin, oficerin e sigurisë dhe punonjësën psiko-social të IAP-së, pas vlerësimit përfundimtar jopozitiv, merr masa për ndjekjen e procedurave administrative sipas akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi.

IV. DISPOZITAT E FUNDIT

1. Agjencia e Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar, brenda 3 muajve nga hyrja në fuqi e këtij udhëzimi, harton metodologjinë për vlerësimin psiko-social të punonjësve arsimorë.
2. Ngarkohen për zbatimin e këtij udhëzimi, Sekretari i Përgjithshëm, Agjencia e Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar, Drejtoria e Përgjithshme e Arsimit Parauniversitar, Drejtoritë Rajonale të Arsimit Parauniversitar, Zyrtat Arsimore Vendore parauniversitare, Komisioni për vlerësimin psiko-social të punonjësve arsimorë dhe punonjësve të tjerë në IAP dhe institucionet arsimore parauniversitare.

Ky Udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI

EVIS KUSHI

